



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL XI/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 11 (njëmbëdhjetë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.11.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

| | | |
|-----------------------|------------------------|-----------------------|
| Z. Shefket Kolgeci | Znj.Saranda Bajraktari | Të pranishëm të tjerë |
| Z.Selman Kolgeci | Z. Driton Maliqaj | Kryetari i Komunës |
| Z. Flamur Bytyqi | Z. Xhevshet Gashi | Media dhe qytetarë |
| Z. Urim Suka | Z.Edon Sadikaj | OSCE, LMT, KDI |
| Z. Kushtrim Kuçi | Z.Dardan Berisha | Znj.Habibe Bytyqi |
| Znj. Elmaze Bytyqi | Z.Bajram Basha | Z.Xheladin Sadikaj |
| Znj. Bulëza Kuçi | Znj.Mevlude Kabashi | |
| Znj.Doruntina Zenelaj | Znj.Sheqerije Zyrapi | |
| Z.Alban Berisha | Znj.Laureta Tafaj | |
| Z. Bexhet Kuçi | Z.Qëndrim Elshani | |
| Z. Reshat Selimaj | Znj.Festë Kabashi | |
| Z. Lirim Qatani | Z.Herolind Limaj | |
| Z. Aziz Bytyqi | Znj. Jehona Rrafshi | |
| Znj.Sanie Kuçi | | |
| Rexhepaj | | |
| Znj.Mimoza Bajraktari | | |
| Znj.Fidaije Kukaj | | |
| Znj. Afërdita Morina | | |

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të performancës për Komunën e Suharekës për vitin 2021;**
- 4. Raporti për procesin zgjedhor të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës;**
- 5. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe fjalën ia jep zyrtarit ligjor i cili ka qenë pjesë e këtij grupi punues për integritet.

Avni Bytyqi - në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe strategjinë shtetërore kundër korrupsionit si dhe planin e veprimit kundër korrupsionit,i hartuar dhe miratuar nga qeveria e Kosovës e cila i obligon të gjitha institucionet shtetërore që të zhvillojnë dhe të miratojnë planet e integritetit,Komuna jonë përmes grupit punues të themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2023-2027 dhe e ka paraqitur para jush për ta shqyrtuar dhe ta miratuar si organ kompetent.Ky plan synon të kontribuoj në ndërtimin e një administrate komunale,profesionale dhe të modernizuar të zhvillimit të qëndrueshëm në aspektin social,ekonomikë dhe lokal me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë pa dallim.Zyrtari ligjor tutje elaboron Planin e Integritetit.

Urim Suka - kur jemi te projekt-vendimi për miratimin e Planit për Integritetin e Komunës për periudhën

2023-2027, konstatoj që në këtë pikë pajtohemi me ju, që Komuna ka nevojë urgjente, madje që ti kthehet integriteti i munguar tash e sa vite dhe me këtë rast falemderoj grupin punues. Shqetësimi që ne kemi është me faktin që qëllimi i këtij pushteti nuk është kthimi i integritet të Komunës, përkundrazi ajo që shohim në kontrata e në punët që ju po bëni e në mënyrën se si po i planifikoni, dëshmon të kundërtën e asaj që në të vërtetë duhet të ndodhë. Mirëpo përkundër të gjithave, ne mendojmë që ky plan duhet të miratohet dhe duhet zbatuar që Komuna jonë të ketë integritet më të lartë. Për këtë ne do ta mbështesim.

Selman Kolgeci - në materialin e këtij plani keni thënë se do të zbatoni në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarte, parime dhe objektiva në parandalimin korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Ju e keni pandeh veten se pa miratimin e këtij plani, ndonjëherë mund të keni bërë veprime anti ligjore dhe tash si masë parandaluese ju ia keni sjell Kuvendit për aprovim. Duke u informuar herë nga afër e herë nga qytetarët dhe duke pasur një pasqyrë të qartë se çfarë keni vepruar në mandatin e kaluar e çfarë po veproni tani, është jashtëzakonisht i nevojshëm miratimi i këtij plani ndërsa po aq i nevojshëm e i domosdoshëm është zbatimi i tij. Si tek fusha e përgjithshme e rrezikut, ashtu edhe tek ato specifike të rrezikut, ekziston një përputhje reale se çfarë duhet të bëni por ju nuk po e bëni. Shumicën e veprimeve që e keni bërë në të kaluarën kanë qenë në kundërshtim me ato veprime që ju do duhej ti bëni dhe ato që janë përshkruar në këtë plan. Për këtë ju kemi kritikuar disa here siq janë rastet kur kemi kërkuar planifikim të mirëfilltë financiar duke u inkorporuar të gjitha palët në menagjimin dhe shpenzimin e mirëfillt të buxhetit, duke mos devijuar vendimet e Asamblesë për buxhetin dhe duke mos rënë në kundërshtim me ligjin për financat publike. Tek prokurimi kemi pas vërejtje të vazhdueshme sa i përket kritereve diskriminuese, hiperbolizimin e sasive në paramasë dhe vlerësimeve favorizuese ndaj operatorëve ekonomikë të afërt me pushtetin. I mirëpresim veprimet që do ti siguronin operatorëve ekonomikë barazi dhe paanshmëri gjatë vlerësimit të ofertave sepse pa dyshim që do ta ruanin buxhetin dhe do të implementoheshin projekte sipas projeksionit kohor. Te çështja e planifikimit urban dhe rural si fushë rreziku e keni cilësuar rregullativën e brendshme që lidhet me planifikimin urban dhe rural, por nuk po shoh që specifikisht keni vlerësuar se edhe hartimi dhe përpilimi i projekteve zbatuese është mangësi që do duhej të planifikohej dhe të merren veprime konkrete për këtë çështje, sepse pos tjerash ka qenë edhe e gjetur e auditorit. Ju sugjeroj ta përfshini këtë çështje në plan. Tek standarti i ndërtimit dhe kontrolli i ndërtimit pa leje ka qenë dhe do jetë brengë e jona se si ka mundësi para syve të qeverisjes komunale të ndërtohet pa leje e të tejkalohet leja ndërtimore. Një plan i tillë është mire që po bëhet dhe do ta mbështesim me vote por shqetësimi është se ju këtë plan po e bëni vetëm për plotësimin e ndonjë kriteri të caktuar dhe jo për ta zbatuar në plotëni.

Qëndrim Elshani - ne e mbështesim miratimin e Planit të Integritetit duke e potencuar që është shumë i rëndësishëm kalimi i kësaj pike të rendit të ditës. Shpresojmë që do t'përmbushet në përpikmëri ky plan i integritet dhe ne e mirëpresim këtë gjë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të performancës për Komunën e Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ju Kryesues përmendet disa nga pikat ku po thoni që vlerësimi është pozitiv.Unë e kam lexu raportin dhe duke e ditë realitetin jam pak i habitur me disa fusha,sidomos te infrastruktura.Kam dyshimet e mia edhe te pjesa e asaj që keni dalë mire.Te pjesa që thoni qyteti i luleve,pikërisht te fusha e mbrojtjes së mjedisi aty Suhareka renditet ka fundi.Te planifikimi hapsinor renditeni e 25-ta.Në fushën e barazisë në punësim, renditeni ulët sepse edhe nga ato që ne po i përcjellim ju keni vazhdu me punësu militantë, por kohën e fundit jeni duke fut njerëz nëpër puna edhe pa procedura.Ky raport i ka në disa fusha gjetjet që nuk keni dalë mire.Nuk ka hapsiër për me u lavdu por ka hapsirë për me mendu dhe me u përmirësu edhe ma mire e sidomos duke u thirrë në raportin për vitin 2022 që e keni marrë.Është mire të reflektoni sepse qasja që keni është e gabueshme.

Kryesuesi - performancën ne nuk e bëjmë,e bën dikush tjetër dhe na dërgojnë në këtë formë.Ne e kemi obligim me sjell këtu për diskutim.

Pika 4. Raporti për procesin zgjedhor të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - I njofton me pikën dhe falemderon komisionin i cili ka pas përgjegjësi të vështirë për Përzgjedhjen e fshatrave.Çdo takim që është mbjatë nëpër fshatra ka një procesverbal,i cili është publiku në faqen e Komunës.Hap debatin dhe fjalën ia jap Drejtoreshës së Administratës si kryesuese e komisionit **Kymete Bajraktari** - përshëndet të pranishmit. I gjithë procesi në përgjithësi i këshillave të fshatrave ka rrjedh pa probleme të theksuara dhe në moment kur kemi has në probleme,qytetarët me koncensus i kanë zgjedh ato çështje.Në çdo takim me qytetarë është mbajtur procesverbali,lista e pjesëmarrësve si dhe janë dhënë sqarime rreth rregullores së punës dhe të njejtën datë janë publikuar në faqen zyrtare të Komunës emrat dhe anëtarët e kryesisë të këshillit të fshatrave.Në raport janë këshillat e 35 fshatrave ku e përfshim edhe fshatin Dragaqinë,pra 36 fshatra.Qytetarët e fshatit Dragaqinë dhe Duhël kanë kërkuar që të përfaqësohen me një këshill të fshatit.Fshatrat si: Sallagrazhda,Delloci,Stravuqina,Qadraku,Tvorani dhe Luzhnica,nuk kanë shpreh interesim me marrë pjesë në takime.Kur do që ata janë të gatshëm,ne jemi në gjendje me shku dhe me kry procesin e formimit të këshillave të fshatrave.Falemderon anëtarët e komisionit për angazhimin dhe korrektësinë e tyre.

Urim Suka - kur jemi te ky raport edhe pse nuk pajtohem me disa çështje,me punën e komisionit,më lejoni ti falemderoj për angazhimin e tyre.Fakti që ky proces në formën si është ndjekur edhe pse ka pas lëshime të shumta,është duke ndodh për here të pare dhe e gjithë kjo është si rezultat i kërkesës që kemi bërë si grup i asambleistëve të LDK-së.Ky proces në nëndegët ku ka pas pajtueshmëri ndërmjet përfaqësuesëve të partive politike është zhvilluar qetë.Këtë proces mendojmë që e ka dëmtuar interpretimi i gabuar i rregullores me rastin e thirrjes publike që është bërë,për faktin se thirrja publike është bërë për të gjithë qytetarët dhe kjo është në kundërshtim me rregulloren.Për kundër kësaj,në shumicën e vendbanimeve zgjedhja e këshillave të fshatrave ka shkuar mire.Unë në KPF kam kërkuar që ky raport të mos sillej në Asamble por komisioni të vazhdoj punën në përmbylljen e procesit pasi që në disa vendbanime ky proces nuk është përmbyllur,siq e tha edhe vet drejtoresha.Gjithëashtu,është i çuditshëm fakti që në fshatin Savrovë mbledhja e këshillit të fshatrave ka dështuar për shkak të mos pjesëmarrësve të përfaqësuesve të partive politike mirëpo përkundër kësaj,këtu në raport figurojnë emrat kinse janë zgjedhur.Këta emra sipas përfaqësuesve tanë janë dërguar pa miratimin e përfaqësuesve të partive atje.Kërkoj sqarime se cila ka qenë

forma se si janë zgjedh këshilli në Savrovë? Gjithëashtu shqetësuese për ne është fakti se në disa vendbanime, për arsye personale kanë munguar anëtarët tanë apo të ndonjë subjekti tjetër dhe ka disa raste që janë krijuar këshilla edhe pa i përfshirë në to të gjitha partitë. Kërkoj nga komisioni që të shqyrtoj secilin këshill veq e veq dhe në ato vendbanime ku nuk janë të përfaqësuara të gjitha partitë në këshill, të shohë mundësinë e plotësimit të tyre sipas formulës që është paracaktuar në bazë të rezultatit të dalë nga zgjedhjet. Gjithëashtu kërkoj nga komisioni që të vazhdojë punën me zgjedhjen e këshillave edhe me vendbanimet e mbetura. Shumë çështje që kanë ndodh nëpër vendbanime nuk pasqyrohen në raportin që e kemi, ku ka pas ndoshta edhe ankesa edhe përgjigje që kemi marrë e nuk figurojnë në raport. Sido që të jetë komisioni e ka përmbush punën e vet dhe unë i falemderoj.

Selman Kolgeci - te kjo pikë e rendit të ditës po mungon procesverbali i cili është në harmoni me udhëzimin administrative dhe rregulloren komunale të cilat sipas vendimit nr.01 410-25500 ka qenë i ngarkuar ky komision ti respektoj dhe ti përdor gjatë zgjedhjes së këshillave të fshatit. Lexon nenin 7 të rregullores Komunale dhe pikën 1 të këtij neni. Ne e kemi pa një listë me emra se kush ku është zgjedh por nuk po shohim një procesverbal të tillë me të dhënat sipas pikes 1 dhe 2 të nenit 7 të rregullores Komunale. Lusim komisionin që ta plotësojë procesverbalin sipas përshkrimeve në nenet përkatëse të ushëzimit administrative dhe rregullores Komunale. Për kërkime të tilla kërkoj sqarime nga përfaqësuesi ligjor se a duhet të pranohet si i tillë pa procesverbal dhe a është respektuar rregullorja dhe udhëzimi administrativ sipas vendimit që kanë pranuar detyrën ky komision.

Kryesuesi - çdo herë procesverbalet e çdo takimi kanë qenë në faqen e Komunes.

Kymete Bajraktari - z. Selman, procesverbalet i kemi dhe janë në detaje, i kemi dhe listat pjesmarrëse dhe nëse doni mbledhjen tjetër mund t'ua sjellim. Ne e kemi pa të arsyeshme që s'ka nevojë për shaka se janë procese në të cilat ka qenë në komision edhe anëtarë juaj.

Selman Kolgeci - ndoshta ju nuk e shihni të rrugës por rregullorja Komunale ka thënë kështu.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime rreth kësaj çështje.

Alban Berisha - është një raport që në mënyrë zyrtare janë zgjedh këshillat e fshatrave që pavarësisht bindjes politike është i mirëseardhur. Ka zgjedhje që ka vërejtje, por më mirë me një zgjedhje me vërejtje se sa pa zgjedhje. Ne si komision kemi qenë para disa sfidave, kemi pas lokacione ku u desh shumë me inkurajë njerëz për me marrë pjesë ose ana e kundërt ku ka pas pjesëmarrje shumë dhe u desh me zgjidh situatë konfliktuoze. Duke pas prasysh migrimin, ka shumë fshatra që kanë mbet pak njerëz dhe këtë punë e quajnë pak a shumë si çështje politike dhe duke ia bashkangjitur që nuk ka ndonjë shpërblim apo pagesë për punën e tyre që do ta bëjnë, ka pas vende ku edhe kanë dështu disa fshatra sepse s'ka pas interesim.

Ka pas raste ku ka pas edhe telashe por nuk ka pas telashe që ja ka vlej me u cek në raport. Fatmirësisht ka shku çdo gjë në rregull, janë bërë me pajtueshmëri dhe aty ku ka pas nevojë janë bërë me vota demokratike. Unë si anëtar i partisë politike i këtij komisioni e them me bindje të plotë që nuk kemi ndërhy si komision dhe nuk ka pas tendenca prej nesh si komision. Falemderoj anëtarët e komisionit që kemi qenë shumë kooperativë pavarësisht bindjeve politike.

Aziz Bytyqi - falemderoj komisionin për punën kolosale që e kanë bërë sepse ka qenë një sfidë të zgjedhen këshillat e të gjitha fshatrave.

Kryesuesi - komisioni ka mandat sa kanë mandat anëtarët e Kuvendit, kështu që 5 lokacionet që nuk e kanë të zgjedhur çështjen e këshillave të fshatrave, komisioni mundet me i formu edhe këto 5 fshatra dhe me ardh me një raport edhe për këto fshatra.

Driton Maliqaj - falemderon anëtarët e komisionit.Pajtohem me gjithë parafolësit e gjithë partive politike,por pajtohem edhe me Albanin ku i potencoj të gjitha sfidat që i ka kalu komisioni.Ne i kemi zbrazëtitrat ligjore edhe te rregullorja dhe te udhëzimi administrativ 02/2019 për zgjedhjet e këshillave të fshatrave.Udhëzimi administrative i viti 2019 e përcakton që në tubim të zgjidhet këshilli dhe rregullorja e thotë pak më ndryshe.E kam pa që komisioni varësisht nga situata e ka zgjidh kontestin të cilin është kriju brenda për brenda subjekteve politike.Mirëpo asnjëherë ky udhëzim nuk e thotë që subjektet politike e zgjedhin kryesinë.Duhet të ulemi dhe të bëjmë një rregullore më të mire të mundshme për zgjedhjen e këshuillave të fshatrave dhe ti referohemi udhëzimit të ri për shkak se kjo rregullore është prej vitit 2012,rregullore e cila ka shërby mjaft mire.

Shefket Kolgeci - nuk morëm përgjigje se si u zgjodh këshilli i fshatit në Savrovë.

Kymete Bjaraktari - në fshatin Savrovë herën e pare s'ka pas interesim, herën e dytë,ne i kemi thënë se nëse ju mundeni me pas koncensus dhe me mbajtë takimin nuk është problem,duhet ti sjellni emrat.Ata i kanë sjell emrat dhe a ka të LDK-së nuk e di sepse nuk e kam shiku përbërjen e asnjë këshilli të fshatit se cilës parti janë.Unë mendoj që është legjitime dhe e kemi paraqit në raport.

Alban Berisha - jep sqarime rreth kësaj pyetje dhe ju bën thirrje qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrjet për vendbanimet e veta, e jo mos të marrin pjesë e pastaj të pyesin se çka po ndodh.

Pika 5. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe fjalën ia jep Nënkryetares së Komunës.

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit.Si në gjithë botën ashtu edhe tek ne,dhuna në baza ginore mbetet një nga shkeljet më të zakonshme të të drejtave të njeriut.Andaj reagimi i duhur nga të gjitha institucionet përgjegjëse ka një rëndësi të madhe për ta luftuar dhe parandaluar këtë dukuri të keqe të shoqërisë.Meqenëse jemi në fushatën sensibilizuese “16 ditë aktivizëm kundër dhunës me baza ginore”,në bashkëpunim me grupin e grave asambleiste,zyrës për barazi ginore dhe disa OJQ-ve,ne si qeverisje kemi marrë disa iniciativa për ta shënuar këtë fushatë sensibilizuese.Falemderoj të gjithë akterët të cilët mirren me rastet e dhunës në familje.Gjatë kësaj periudhe kohore janë ngrit disa iniciativa nga gr. i grave të Asamblesë Komunale dhe disa rekomandime të dala nga mekanizmi kundër dhunës në familje,si: vendimi i mbështetjes së strehimores, bonus banimi, fondi emergjent, funksionalizimi i zyrës për shërbime juridike falas,subvencionimi i rasteve të dhunës nga ana e zyrës së kryetarit, e të tjera.Sa i përket rasteve të dhunës në familjet të ndodhura në periudhën janar - nëntor 2022,statistikat tregojnë se kemi rënie.Nga raportimet e stacionit policor kemi 54 raste në janar-nëntor,ndërsa sipas raportimeve të QPS-së në vitin 2022 janë 29 raste ndërsa në 2021 kanë qenë 33 raste dhe nga raportimet e QKMF-së janë 18 raste në 2022 dhe në 2021 kanë qenë 35 raste.Kjo rënie e lehtë e rasteve të dhunës na gëzon,mirëpo ne duhet ende të punojmë që jo vetëm të minimizohet por edhe mos të ketë fare dhunë në familjet tona.

Sanie Kuçi Rexhepaj - 16 ditë nuk mjaftojnë në vit që ne ta ngrisim zërin për parandalim dhe vetëdijësim.Si gr. i grave ne do të mundohemi maksimalisht që rekomandimet tona ta ken efektin e duhur.Vizita që realizuam me gr. e grave në Qendrën për strehimin e grave dhe fëmijëve në Prizren,na motovoi edhe më shumë,andaj e mbështetëm edhe ma tutje rekomandimin tone që të ripërtërihet marrëveshja për mbështetje financiare dhe ajo të rritet.Në emër të gr. të grave falemderojmë Kryetarin dhe Nënkryetaren që morën për bazë rekomandimin tonë dhe vlerën financiare për këtë qendër e rritën po thaj

100%.Siç e dini Komuna funksionon edhe me një mekanizëm kundër dhunës në familjet,ku dalin rekomandime mjaft të rëndësishme.Në këtë mekanizëm potencohet që riintegrimi i viktimave është jashtëzakonisht sfidë e madhe.Bonus banimi është një ndihmë sa do e vogël por që rastet përfituese janë në numër të vogël dhe përfshihen rastet sociale.Andaj si grup i grave e kemi përkrah projekt-propozimin nga academia VIVIEN e cila do të ofrojë minimum 2 bursa për aftësim profesional për viktimat e dhunës në familje.Ky projekt ka mbështetjen e plotë të kryetarit të Komunës,i cili ka ofruar edhe një burse përmes një marrëveshje që do të bëhet së shpejti me akademinë.Gjithëashtu jemi në pritje edhe të Qendrës së Bizneseve t'na konfirmojnë rreth mundësisë së kontribimit në këtë aspekt.

Shefket Kolgeci - për luftimin e dhunës në familje dhe dukurive negative që janë në shoqëri,mendoj që barren kryesore e ka Qeveria Qëndrore dhe Qeveria Komunale.Duhe të jepen fonde prej qeverisë por dhe Qeveria komunale duhet të ndaj fonde.Le ti bje në Asamble dhe ne do ta përkrahim të gjithë.Kjo duhet të jetë sistematike dhe gjatë tërë vitit duhet të bëhen programe të caktuara përmes televizioneve,përmes organizimeve nëpër shkolla që ti sinsebilizojmë qytetarët.Unë personalisht dhe grupi im për çdo iniciativ që do të vje në Asamble për mbështetje financiare,do ta përkrahim.Sa i përket pengimit të dhunës,duhet të intervenohet menjëherë kur lajmërohen rastet.

Nënkryetarja - ne si qeverisje kolale po bëjmë përpjekje që ta ndihmojmë gruan.Jeni të informuar që në buxhetin e viti 2023 me iniciativën e grupit të grave,ne kemi kërkuar buxhet prej 50 mijë euro për ndihmesën e start apeve.I kemi në planifikim për vitin 2023.

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Jehona Rrafshi - a jeni në dijeni se sipas ligjit për qeverisje lokale,Kuvendi Komunal përkatësisht Drejtoria e Inspeksionit në vitin 2018 ka përgatitur rregulloren për transportin rrugor e cila me 36 dhjetor 2018 është miratuar edhe në Asamble.Neni 40 i kësaj rregullore thotë që rendi i udhëtimit për operatorë vlen 3 vite dhe mbas tre viteve duhet të bëhet vazhdimi i rendit të udhëtimit.Janë bërë 9 muaj që nuk është vazhduar rendi i udhëtimit.A është bërë diçka lidhur me këtë drejtim sepse ende nuk kemi parë ndonjë njoftim që është vazhdu rendi i udhëtimit.

Albulena Kokollari - e kemi bo njoftimin për vazhdimin e rendit të udhëtimit, mandej është formu komisioni me vendim të kryetarit.Komisioni ka pas probleme dhe ende është duke u marrë me këtë çështje dhe besoj që janë në përfundim dhe shumë shpejt do të bëhet vazhdimi i rendit të ditës.

Urim Suka - është e nevojshme me qenë Kryetari sepse shumica e shqetësimeve të qytetarëve janë drejt për drejtë për të.1.Pyetja ka të bëjë me ndërtimin e rrugëve në Sallagrazhdë.Këtu kam kontratën e viti 2022 ku janë planifikuar ndërtimi i rrugës Zef Tunaj,Mehmet Aliaj-seg,9 Maji dhe Avdyl Ramadani,por sipas informatave që kam marrë të gjitha rrugët që janë në kontratë në vitin 2022 janë të shtruara nga vitet e kaluara.Kërkoj të di nga Drejtori i SH.Publike se ku kanë shkuar këto mjete pasi rrugët janë të shtruara dhe cila është procedura që është ndjekur për ndërtimin e rrugëve tjera jasht kësaj kontrate. 2.Ndërtimi rrugës Bllacë-Ngucat,investim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës, e cila ka mbetur pa u përfunduar.Kjo ka ndodh pasi një qytetarë që banon në atë pjesë ka pas një kërkesë për ndërtimin e një muri mbrojtës rreth 20 m gjatësi për sigurinë e familjes së tij.Unë e kam vizituar këtë vend dhe jam njoftuar se qytetarit i është kërkuar ta largojë një shupë,me idenë që të ndërtohet muri në atë pjesë.E vërteta është që qytetari e ka largu shupën mirëpo muri nuk është ndërto fare.Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit, janë ndërprë punimet

dhe rruga është e papërfunduar. A mund të di pse janë ndërprerë punimet dhe gjithëashtu me sa unë di, ju për vitin e ardhshëm nuk keni planifikuar buxhet për këtë rrugë.

Kërkoj që të bëni zgjidhje për këtë rrugë. 3. Bëhet fjalë për rrugën në lagjen Zekolli që lidhet me varrezat e kësaj lagje, ku janë edhe disa shtëpi banimi. Kjo rrugë për veq që është e pa rregulluar, uji nga reshjet e fundit e ka dëmtuar edhe më shumë. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta vizitojë këtë rrugë dhe të vendos për zgjidhjen që duhet bërë sepse është vështirë për tu kaluar. 4. Ka të bëjë me një kërkesë të një fermeri në Bllacë Avdullah Bajraktari. Dua të di se pse nuk janë adresuar kërkesat e tij deri më tani dhe kërkoj nga Drejtori i Bujqësisë që ta vizitojë menjëherë këtë fermë dhe ti adresoj kërkesat që ai ka e që ju jeni zotuar që do ti dilni në ndihmë dikur.

Enver Shabani - është e vërtetë ajo që the për Sallagrazhdë sepse kodet janë bartë që nga viti i kaluar. 30 mijë euro kanë shku në Salagrazhdë në disa rrugë të tjera. Sa i përket rrugës Ngucat-Bllacë, kemi pengesë nga një qytetarë. Drejtori i Pronës dhe Katastrës ka dal në teren dhe është konstatu që rruga është pronësi private, andaj edhe ne i kemi pezullu punimet. Sa i përket rrugës në Bllacë, të dielën e kemi vizitu me asambleisten Bajraktari dhe asambleisten Lumi. Është vështirë e kalueshme, por e kalueshme dhe ishte një pjesë pa kanalizim ku do të shohim se çka do të mundemi me bë.

Ardian Kotorri - është një pyetje e rëndësishme por megjithëatë do të kthehmi në retrospektiv. Nëse s'gaboju në fillim të vitit Drejtorisë së Bujqësisë i kanë dal në fondin rezervë rreth 410 mijë euro, ku në kuadër të tyre ka qenë edhe projekti për ndërtimin e shtallave për bagëti dhe ne nuk kemi pas mundësi në këtë drejtim. Këtë vit kemi shku prej subvencioneve në ndërtimin e serave. Drejtori tutje jep sqarime rreth kësaj çështje.

Urim Suka - Drejtor i Shërbimeve Publike, ju u pajtuat me atë që thash unë por pyetja ishte se cilën procedure e keni ndjekur për me i ndërru ato rrugë? Çështja te rruga Zekolli, qytetari nuk është pengesë për me kry atë rrugë por kërkesa etij ka qenë bazike për me bo murin mbrojtës për sigurinë e familjes së tij sepse rruga është në kthesë dhe është rrezik. Sa i përket Drejtorit të Bujqësisë, unë nuk kërkoja raport për drejtorinë sepse e di atë që ka ndodhë, por në qoftëse është e nevojshme shkojmë te qytetari, e vizitojmë, ndëgjoj kërkesat që ju ka thënë para një viti dhe ndëgjoj edhe tash dhe provo me i bo zgjidhje sepse është duke investu shumë.

Ardian Kotorri - kur do që je i gatshëm ne do ta vizitojmë fermerin në fjalë.

Kushtrim Kuçi - e kam një lutje për Drejtorinë e Kulturës që nëse është mundësia, në fushën e sportit "13 Qershori" me pas një monitor dhe besoj që është e qëllueshme sepse klubi i basketbollit Ylli e ka meritë.

Lorika Gashi - po e kemi mendu dhe më herët por shkaku i buxhetit s'kemi pas mundësi diçka me bo dhe për vitin e ardhshëm e kemi në plan të prokurimit që për pjesën teknologjike kemi nda buxhet.

Selman Kolgeci - 1. z. Bajselmani, në shkollën fillore në fshatin Vraniq mungon uji i pijes tash e disa vite dhe nyjet sanitare janë larg standarteve dhe me mundësi të përhapjes së ndonjë sëmundje. Kërkoj që në bashkëpunim me këshillin e fshatit dhe këshillin drejtues të shkollës të bëhet një zgjidhje për furnizim stabil me ujë të pijshëm dhe te çështja e dytë kërkoj që të merren masa dhe të menjahohen çoftë defektet sipërfaqësore, çoftë ato që dojnë trajtim më të avancuar. Poashtu është hera e tretë që po kërkoj raport nga drejtoria juaj për shpenzime të gjykatave. 2. Për Z. Shabani: e kemi pa një aktivitet tek kanali i Dybiqakut, a ka mundësi me na tregu se çka po investohet aty, me cilin projekt dhe me cilin kod buxhetor. Kam një kërkesë për intervenimin në ndriçimin publik në fshatin Vraniq te rruga Agushajt.

3. Drejtorisë së Kulturës: faleminderit që e keni sjell materialin e kërkuar në seancën e kaluar dhe të lutem kur të përfundojnë punën OJQ-të, edhe një herë na i sillni materialet sepse disa prej OJQ-ve akoma nuk e kanë përfunduar aktivitetin e tyre. Ndërsa sa i përket përgjigjes që e ka kthyer komisioni për vlerësim profesional të teatrove, e them me keqardhje se nuk keni treguar angazhim serioz për themelimin e teatrit. Ky komision ka gjetur mospërputhje që Komuna jonë ka në raport me rregulloren 04/2015 për themelimin e teatrove. Ky komision ka dhënë rekomandim dhe ka treguar gadishmërinë për ta mbështetur Komunën tonë në të gjitha format e mundshme në procesin e themelimit të teatrit në Suharekë. E keni marrë përgjigjen dhe nuk dim çka keni bërë tutje. Kërkojmë më shumë informacion dhe nëse ka afate ligjore, me i shfrytëzuar ato dhe me fillu me i bërë përmirësimet të cilat i ka rekomanduar dhe me themelimit teatrit.

Remzi Bajselmani - për gjendjen në shkollën e Vraniqit jam i informuar. Kemi bërë përpjekje për këtë situatë dhe na kanë premtuar disa anëtarë të kryesisë së fshatit që do ta bëjnë një projekt dhe ne kemi shprehur gadishmërinë për me mbështetë financiarisht, por nuk na kanë sjellur ende projektin. Jemi në pritje të ndërtimit të shkollës e cila është vonë shumë sepse e dim se si është situata në shkollë. Sa i përket raportit lidhur me shpenzimet, ju e keni bërë një publikim dhe e keni quajtur një keqmenaxhim dhe keni thënë se është dëmtuar Komuna e Suharekës rreth 1 milion euro. Unë e kam thënë edhe më herët që nuk jemi dëmtuar si komunë, asnjë projekt nuk është ndal. Ne i kemi nxjerrë të dhënat dhe raporti është se si kanë shkuar mjetet por ju e keni publikuar. Mund t'ua jap por është pak i ndieshëm sepse është me emra të secilit person.

Selman Kolgeci - kemi kërkuar të dime sa mjetet i kanë shkuar përmbaruesëve, sa avokatëve dhe sa mësimdhënësve. Te çështja e ujit në shkollën e Vraniqit, unë do të interesohem dhe nëse nuk është hartuar së paku një projekt ideor, e marr përsipër vet me bashkëpunëtorët e mi me përpiluar një projekt dhe me ju sjell juve vetëm me rregulluar atë çështje.

Remzi Bajselmani - nëse mundeni me dhënë kontribut, ne e mirëpresim dhe do ta realizojmë.

Enver Shabani - lidhur me investimet në Dybyqak, ky është një projekt tri vjeçar, një kontratë e lidhur me ministrinë dhe operatorin ekonomik. Drejtori tutje jep sqarime rreth kësaj çështje. Sa i përket ndriçimit publik në lagjen Agushaj, ne e kemi një kontratë të hapur për mirëmbajtjen dhe sanimin e ndriçimit publik, kontrata nuk ka qenë e favorshme sepse ka qenë vetëm një operator ekonomik por sido çoftë jemi duke u marrë me sanimin e ndriçimit. Sa i përket procedurave për Sallagrazhdën, të njëjta procedura kanë filluar duke kalkuluar brenda mjetëve që kanë qenë për 30 mijë euro. Të njëjtat kanë shkuar në Sallagrazhdë por në rrugë të tjera.

Lorika Gashi - Selman gjithësesi do ta marrësh edhe raportin e fundit edhe pse gjatë kësaj jave kanë qenë 5 aktivitete të cilat kanë qenë të subvencionuara nga drejtoria jonë, dhe janë në procedurë. Drejtoresha jep sqarime edhe sa i përket çështjes për themelimin e teatrit.

Selman Kolgeci - në rekomandim na kanë thënë që ministria është e gatshme me na mbështetë. Nëse ju nuk jeni adekuat me vlerësimin, është dashtë me kërkuar mbështetje prej ministrisë ose prej fakultetit të arteve. Te çështja e objektit, ne e kemi pas një marrëveshje me shtëpinë e Felbahut që ka thënë nuk i plotëson kriteret dhe ne jemi dorëzuar. Ju si drejtori duhet të angazhoheni që shtëpia e kultures ti plotësojë kriteret e teatrit. Nëse ka kohë akoma duhet me u marrë me këtë punë.

Lorika Gashi - sa i përket interesimit se sa aktorë ose sa regjisorë i kemi, konkretisht kemi pas takim me sekretarësh e fakulteteve të arteve, ku e kemi marrë një listë dhe vendet ku punojnë aktorët tanë. Sa i përket hapsirës së objektit të teatrit që pritet me u bërë, kushtet i plotëson dhe është hapsira e mjaftueshme.

Qëndrim Elshani - jemi dëshmitarë të një krijimi të një interpretimi të një stacioni të autobusave përballë muzeut. A është legal apo jo ? nëse jo, Drejtoria e Inspeksionit duhet me ndërmarrë masa, nëse po, është një stacion i vjetër i pa shfrytëzuar përballë shtëpisë së Felbahut dhe të paktën është mire me zhvendos dhe me vendos te stacioni ku presin qytetarët në mënyrë që mos të lagen prej shiut apo borës.

Visar Kuçi - e kemi bërë një analizë për atë pjesë dhe një nënstacion është për udhëtarët që shkojnë për Prizren dhe një tjetër është përballë Vivës që zbrasin. Kemi nevojë për një nënstacion përballë Rozit, por në këtë fazë nuk kemi mujt me realizu për shkak se nuk kanë përfunduar punimet të shtëpia e kultures, edhe pse është e nevojshme ky nënstacion.

Shefket Kolgeci - e kam ngrit një shqetësim në muajin qershor rreth dekorimit të qytetit me flamuj dhe po e shoh që jeni korigju. Pyetje Drejtorit të Bujqësisë: A e keni përfunduar ndarjen e subvencioneve për makinat mbjellëse, spërkatëse etj, nëse po kërkojmë një raport për mbledhjen e ardhshme.

Ardian Kotorri - të hyrat vetanake të vitit 2021 janë aloku disa here, por herën e fundit janë aloku në shtator dhe kanë qenë rreth 110 mijë euro. Planifikimi ka qenë prej atij buxheti por realisht kemi problem sepse ministria e financave nuk po na alokon këto 110 mijë euro. Ne jemi duke bërë përpjekje dhe besoj shumë shpejtë do ta publikojmë listen e rezultateve.

Jehona Rrafshi - firma e cila ka qenë e kontraktuar për rrënimin e objekteve pa leje dhe rrezikshmëri, edhe kjo kontratë ka skaduar që disa muaj. Si është e mundur që Drejtoria e Inspeksionit të rrijë pa një kontratë të tillë dhe pse po vonohet kjo procedure? Nëse ka përfunduar, cila firmë është fituese?

Albulena Kokollari - është e vërtetë që ka skaduar. Është në fazë të prokurimit për here të dytë dhe është në procedure sepse fazën e parë nuk ka aplikuar askush.

Festë Kabashi - temën e qenve endacak e kam trajtuar edhe në njërin nga seancat e mëhershme dhe sot po hap si temë me shkas meqenëse gjatë muajit gusht Komuna e Ferizajit ka njoftuar që do ta funksionalizojnë qendrën e përkohshme për trajtimin e qenve endacak. Më intereson të di nëse keni informacion për këtë iniciativë. Nëse po, a do të mund të merrni ndonjë ide apo praktikë që të njejtën iniciativë ta ndërmarrim edhe ne, dhe nëse jo, ju inkurajoj që sa më parë të informoheni për këtë projekt me rëndësi që do të ndikonte në sigurinë publike të qytetarëve tone.

Ardian Kotorri - ne realisht kemi pas buxhet për trajtimin e qenëve endacak mirëpo lënda ka qenë në OSHP dhe në momentin që ka përfunduar, OSHP-ja e ka kthyer dhe ne kemi filluar me procedure dhe mendoj që sivjet prap lënda është në OSHP. Ne si qeveri jemi të shqetësuar dhe së bashku me Kryetarin jemi në diskutim me disa organizata për një zgjidhje më afatgjatë.

Enver Shabani - një vajzë nga Mushtishtja që jeton në Zvicërr ka një organizatë për trajtimin e qenve e cila ka bërë një kërkesë për dy ha tokë. Kryetari I ka ofruar mbështetje dhe nëse ajo është e gatshme me vazhdu përndryshe nuk ka ndonjë procedure tjetër.

Takimi përfundoi: 12:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj